

Partitë Politike Shqiptare të Kosovës dhe Veriu

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Përfshirëse (CIG) ka organizuar më 2 tetor, 2012 në Prishtinë një tryezë të rrumbullakët për përfaqësues të partive politike shqiptare të Kosovës, zyrtarë qeveritar, dhe anëtarë të shoqërisë civile, përfshirë organizata lokale joqeveritare dhe media.

Qëllimi i këtij takimi ka qenë diskutimi i çështjes së veriut në kuadër të dialogut të rradhës mes Prishtinës e Beogradit dhe mundësitë për arritjen e konsensusit rreth kësaj çështje ndër akterët e spektrit politik të shqiptarëve të Kosovës. A kanë partitë politike shqiptare konsensus rreth zgjidhjes së problemit të veriut? A është e mundur të përmirësohet bashkëpunimi mes partive politike në qeveri dhe atyre opozitare sa i përket çështjes së veriut? Si mund të kontribuojnë partitë politike në dialogun me serbët në veri? Si mund të ndihmojnë organizatat e shoqërisë civile për arritjen e konsensusit nacional për zgjidhjen e çështjes së veriut? Takimi ka shërbyer si platformë për akterë të ndryshëm që ti shprehin pikëpamjet e tyre rreth kësaj çështjeje.

Pjesëmarrësit në diskutim kanë folur në cilësinë personale. Ky raport nuk ofron pasqyrë complete të diskutimeve. Raporti nuk është rishikuar nga pjesëmarrësit dhe CIG mban përgjegjësinë për përmbajtjen e tij. Raporti është përgatitur nga Arber Kuci, koordinator i programit të CIG në Kosovë.

Partitë politike shqiptare të Kosovës janë të bashkuara në dëshirën e tyre që të zgjidhin çështjen e veriut, por dallojnë në qasjet e tyre. Disa kanë thënë se pasiqë veriu është çështje e brendshme e Kosovës, ajo duhet të diskutohet vetëm nga ata të cilët jetojnë në Kosovë dhe nga institucionet e Kosovës. Disa pjesëmarrës tjerë e kanë lënë të hapur mundësinë e përfshirjes së Beogradit në proces, duke thënë se problemi është shkaktuar nga politikat e qeverisë së Serbisë dhe nga prezenca e saj në veri dhe se nuk mund të zgjidhet pa folur me Beogradin. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve kanë qenë mjaft të qartë rreth faktit se zgjidhja e këtij problemi do të hapte rrugën për të trajtuar problemet tjera madhore të Kosovës sic janë ekonomia, papunësia dhe standardi i përgjithshëm i jetesës.

Arritja e konsensusit ndërpartiak

Përderisa urgjenca e kohës është konsideruar me rëndësi, vendosja politike e Kosovës në lidhje me komunitetin ndërkombëtar pas bisedimeve teknike të përfunduara vitin e kaluar është konsideruar e pakënaqshme. Disa anëtarë të partive opozitare u shprehen se qëndrimi i Kosovës në bisedimet e mundshme politike për veriun vjen nga një ekip që din që loja është shitur, por megjithatë dëshiron të luaj.

Sipas një bashkëbiseduesi, brenga dhe nxitja kryesore e politikave të Serbisë ndaj Kosovës ka qenë me shumë territori sesa popullata. Ai shtoi se Kosova veçse ka një histori të përfshirjes në bisedime me Serbinë në formë ad hoc dhe kështu insiston që është më rëndësi për Kosovën të futet në këtë dialog vetëm atëherë kur të vendosen elementet thelbësore mbi të cilat do të bazohet diskutimi. Në mënyrë që të arrihet kjo shkallë, pjesëmarrësi ka thënë që janë dy çështje të cilat duhet të adresohen: së pari, duhet të arrihet një konsensus i brendshëm i të gjitha partive shqiptare dhe kjo nuk mund të arrihet pa përfshirjen e komunitetit ndërkombëtar; dhe së dyti, Prishtina duhet të futet në dialog me Beogradin me më shumë mundësi, duke përfshirë edhe ato të rivendosjeve territoriale. Përderisa çështja e parë është e “vështirë por diçka që mund të bëhet,” e dyta duhet të diskutohet sipas termave të strukturave ndërkombëtare në lidhje me mosmarrëveshjet territoriale.

Ky pjesëmarrës përmendi nocionin e ‘reciprocitetit’, duke iu referuar marrëdhënies në mes të respektit të të drejtave minoritare të shqiptarëve në Serbi, përkatësisht në rajonin e njohur si Lugina e Preshevës. Folësi ka argumentuar që Kosova ka siguruar një nga strukturat më të mira politike për zhvillimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut të minoritetit serb në Kosovë dhe se Serbia duhet të sigurojë një pako të ngjajshme për shqiptarët që jetojnë në jug të vendit.

Një pjesëmarrës tjetër e çoi këtë argument më tej duke thënë se nevojitet një konsensus ndërmjet partive qeveritare dhe partive opozitare shqiptare. Mirëpo ai ka thënë se një konsensus i tillë apo çfarëdo forme e unitetit do të duhej të kishte një qëllim të përcaktuar dhe objektiva të qarta. Si pengesë e mundshme në këtë drejtim u përmend mungesa e besimit ndërmjet partive. “Vitin e kaluar na është thënë së nuk do të ketë dialog politik [me Beogradin], vetëm bisedime teknike, dhe tani të gjithë e dimë se ky nuk ka qenë rasti,” ka thënë pjesëmarrësi. Për më tepër folësi ka thënë se çdo konsensus kombëtar mbi këtë çështje është i kushtëzuar nga trajtimi i aktiviteteve kriminale në veri, një trend i përsëritur, i cili sipas folësit nuk është luftuar nga qeveria për shkak të përfshirjes së dyshuar të disa politikanëve në veprimtari të tilla. Sipas pjesëmarrësit, një pikë tjetër në të cilën opozita e ka mbështetur qeverinë ishte në korrik të vitit 2011, kur Prishtina është vënë në lëvizje për të vendosur autoritetin e saj në dy vendkalimet kufitare në veri. “Më 25 korrik, ne kemi mbështetur qeverinë, por koha që ka kaluar që nga atëherë ka treguar që ndërhyrja ka pasur si qëllim të vetëm heqjen e njëres nga të drejtat e çdo shteti normal, përkatësisht të drejtën e ndërhyrjes” theksoi pjesëmarrësi.

Një pjesëmarrës tjetër i diskutimit ka thënë që nuk ka vizion përbrenda spektrit politik shqiptar sa i përket zgjidhjes së çështjes së veriut. Pjesëmarrësi ka argumentuar që një konsensus kombëtar i mundshëm, do të duhej të ndërtohej mbi platforma të ndryshme që do të paraqiteshin nga secila parti politike. Ai ka shtuar se partitë politike duhet të pajtohen rreth një qëndrimi të përbashkët pas analizës së përbashkët të të gjitha ideve. Ai poashtu ka theksuar faktin që në të shumtën e rasteve, për shkak të mungesës së këtyre ideve, partitë politike kanë tendencë të mbështeten pothuajse ekskluzivisht në inputin e komunitetit ndërkombëtar.

Sipas këtij folësi, serbët në veri shpesh ndajnë brengat e njejta me shqiptarët në pjesën tjetër të Kosovës. “Jam takuar me kryetarë [serb] të komunave paralele. Ata më thonë, “edhe nëse pranojmë të jemi pjesë e tablosë politike të Prishtinës, kush garanton se votat tona nuk do të vidhen?” përfundoi ai.

Mungesa e iniciativës nga ana e partive politike shqiptare ishte poashtu pika kryesore e veçuar nga një pjesëmarrës tjetër, një përfaqësues i shoqërisë civile. Sipas këtij folësi, që të dyja, si qeveria ashtu edhe partitë politike, deri më tani më shumë janë angazhuar në retorikë sesa në propozimin e zgjidhjeve pragmatike. Institucionet e Kosovës kanë kërkuar nga komuniteti ndërkombëtar që t'ua shërbejë një zgjidhje të gatshme, përderisa komuniteti ndërkombëtar ka kërkuar nga udhëheqësit e Kosovës që të ndërmarrin veprime. Folësi ka argumentuar se si qeveria ashtu dhe opozita, janë duke vepruar “në mënyrë taktike dhe jo strategjike.” Në mënyrë që të përfshihet në proces më produktiv, Prishtina duhet të krijojë një kanal komunikimi të qëndrueshëm me serbët në veri. Ai ka thënë se përgjatë procesit, qeveria do të jenë në gjendje t'i identifikojë bashkëbiseduesit me të cilët eventualisht mund të bëhen marrëveshje politike dhe marrëveshje tjera.

Stabilizimi politik i Kosovës dhe progresi i saj i përgjithshëm nëpër vite ka qenë pjesë e përpjekjeve ndërkombëtare që rezultoi më deklaratën e pavarësisë në shkurt të vitit 2008. Në këtë kontekst, Kosova nuk mund t'i japë vetes lirinë për të vendosur e vetmuar për një numër të çështjeve kryesore, siç është veriu. Sipas një zyrtari të qeverisë, çështja e veriut më shumë kërkon zgjidhje sesa pyetje. “Kosova nuk është në pozitë të vendosë vija të kuqe pasiqë rëndësia e saj në kontekstin global të marrëdhënieve ndërkombëtare është në rastin më të mirë, tepër e vogël.” Sipas këtij pjesëmarrësi çështja e veriut është qartazi një çështje ndërkombëtare, pasi që vet shteti i Kosovës dhe subjektiviteti i saj politik e ligjor është një projekt ndërkombëtar. “Veriu nuk është çështje e brendshme e Kosovës. Çështje të brendshme janë rryma elektrike dhe ujërat e zeza,” ka thënë pjesëmarrësi, duke shtuar që një tipar tjetër që vjen si rredhojë e rrethanave të tilla është mungesa e fuqisë së Kosovës, si mjet potencial për ndryshime të mundshme.

Në muajt e fundit, çështja e veriut ka qenë në krye të agjendës së qeverisë dhe skenës politike si dhe të mediave. Sipas folësit të njejtë, kjo shpesh ka kontribuar në një polarizim të lartë ndërmjet partive politike si dhe ndërmjet koalicionit qeverisës dhe opozitës.

Nga ana tjetër ky polarizim ka krijuar dy blloqe politike lehtë të dallueshme. Bllokun e parë ai e ka quajtur “blloku i kompromisit” i cili shihet si bashkëpunues dhe i gatshëm për të arritur kompromis; blloku tjetër ekziston vetëm mbi premisën e kundërshtimit të një qasjeje të tillë, të cilin pjesëmarrësi e quajti si “blloku i mohimit”. Si pasojë, veriu shpesh përdoret nga partitë opozitare më parë për të venë në rrezik qeverinë e Kosovës sesa Kosovën si shtet, duke thënë se të bisedohet me Serbinë është e barabartë me tradhëtinë dhe mos te bisedohet është shenjë e patriotizmit. Pjesëmarrësi ka theksuar se sa i perket partive opozitare, muajt në vijim për disa do të jenë mundësi për të ndërruar qasjen e tyre ndaj veriut përderisa për të tjerët do të jetë mundësi për të punuar drejt rrëzimit të qeverisë. Mirëpo, nevoja për gjetjen e një zgjidhjeje përfshin domosdoshmërinë për kompromis, dhe një kompromis i tillë në politikë pothuajse asnjëherë nuk pritet mirë. “Ne nuk jemi këtu për të gjetur të vërtetën por për të gjetur kompromis,” ka thënë ai. “Në mënyrë që ta ruash sovranitetin tënd, duhet te flasësh me ata që shkelin sovranitetin tënd”, pohoi një pjesëmarrës tjetër.

Ideja që Kosova mund të hyjë në dialog pa komunitetin ndërkombëtar u konsiderua joreale nga një pjesëmarrës tjetër. Sipas këtij folësi, Kosova së pari duhet të vendos nëse dëshiron ta mbajë veriun brenda territorit të saj apo është në favor të shkëmbimit territorial. Nëse mendimi i

përgjithshëm politik është në favor të mendimit të parë, atëherë Kosova duhet t'i dijë instrumentet dhe kufizimet e saja në lidhje me zgjidhjen e çështjes, ka argumentuar folësi. Ai poashtu veçoi një numër tjetër rrethanash që lenë pak apo fare vend për Kosovën për të manovruar në situatën e tanishme. "Nëse pritët nga BE-ja që t'i bëjë presion Serbisë që t'i tërheq forcat e sigurisë nga Kosova, atëherë çka nëse ne kemi konsensus se nuk dëshirojmë të flasim me Serbinë? Unë mendoj se Kosova nuk e ka fuqinë të veprojë në atë mënyrë."

Sipas një pjesëmarrësi tjetër, as Kosova nuk mund t'a inicojë procesin, e as Serbia nuk mund të ndikojë në të. Në këtë kuptim, rregullat janë të vëna dhe ato ndërrohen gjatë lojës. "Ne nuk mund të kërkojmë një situatë ose-ose, por më parë duhet provuar të arrijmë konsensus. Politika është një zanat i adaptimit." Një pjesëmarrës tjetër ka theksuar nevojën e Kosovës për t'u siguruar që veriu i Kosovës mos të dalë nga "struktura ndërkombëtare e politikës dhe të shndërrohet në një Nagorno-Karabakh tjetër". Përderisa mbetet në strukturat e marrëdhënieve ndërkombëtare, Kosova ka gjasa më të mira për ta zgjidhur çështjen në favor të saj, ka shtuar ai.

Një pjesëmarrës nga një parti opozitare tha se Kosova, si çdo shtet tjetër normal, duhet të ketë ushtrinë e saj dhe duhet të përforcojë edhe më tej forcat e saja policore. Sipas këtij folësi, mjeti i forcës duhet të përdoret në marrëveshje me NATO-n dhe vendet që përkrahin Kosovën, në rast se ndërhyrja ushtarake konsiderohet e domosdoshme për shkak të një dështimi të mundshëm të zgjidhjes së çështjes së veriut në mënyrë diplomatike. Mirëpo një pjesëmarrës tjetër nga opozita nuk u pajtua më këtë pikëpamje. Atij kjo ide i është dukur sa joefektive po aq utopike. "Po të kisha dy jeta do t'ju bashkohesha, por kam vetëm një," tha ai. Ai vazhdoi duke theksuar nevojën e Kosovës për t'u bërë një shtet 'normal' dhe atraktiv për të gjithë qytetarët e saj. Për më shumë, sipas tij, Serbia është e obliguar të flasë me Kosovën vetëm për shkak të pranisë së SHBA-së dhe BE-së në Kosovë, duke theksuar nevojën e Kosovës për t'i koordinuar veprimet në veri me partnerët e saj ndërkombëtar. Të gjithë pjesëmarrësit u pajtuan se fuqia e dhunës e Kosovës në rastin më të mirë është e kufizuar dhe se kjo forcë do të duhej të përdorej vetëm si mjet i fundit.

Një nga pjesëmarrësit poashtu përmendi se ekzistojnë dy shkallë të dialogut në të cilin me shumë gjasë Prishtina do të futet në të ardhmën e afërt. Shkalla e parë e dialogut është ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, dhe shkalla e dytë është ndërmjet Prishtinës dhe veriut. Përderisa shkallës së parë i duhet një konsensus ndërmjet spektrit politik shqiptar, dialogu ndërmjet Prishtinës dhe përfaqësuesve serbe në veri jo domosdoshmërisht kërkon një konsensus të gjerë të brendshëm. Një folës tjetër ka thënë se cilido që të jetë rasti, serbët në veri nuk do të diskutojnë me autoritetet në Prishtinë pa përfshirjen e Beogradit. Ai vazhdoi duke thënë që kjo duhet të kuptohet nga autoritetet në Prishtinë të cilat duhet të fillojnë t'a konsiderojnë dialogun më tepër si mjet negociues dhe të politikave sesa si një kompromis të mbyllur dhe i vulosur.

Përfundimi

Mendimi i përgjithshëm i pjesëmarrësve në tryezë ishte se zgjidhja e çështjes së veriut është vendimtare dhe urgjente për stabilitetin politik afatgjatë dhe zhvillimin ekonomik. Shume nga problemet me të cilat përballët Kosova sot janë lënë dhe vazhdojnë të lihen pas dore si pasojë e dominimit të çështjes së veriut mbi çështjet e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik. Disa folës kanë thënë se përveç përfaqësimit politik të komunitetit serb, Kosova ofron pak nxitje për serbët, apo dhe për shqiptarët, për të dëshiruar të jetojnë dhe të përparojnë në këtë shtet. Kjo pikë është

theksuar nga njëri prej pjesëmarrësve që poashtu ka theksuar se kjo çështje nuk është më rëndësi vetëm për komunitetin serb por poashtu edhe për shumicën shqiptare. “Çfarë iu ofron Kosova jo vetëm serbëve por edhe shqiptarëve si nxitje për të jetuar këtu?” ka pyetur njëri nga pjesëmarrësit e partive opozitare, “A mund t’a ndërtojmë një Kosovë atraktive? A mund t’ju tregojmë qytetarëve që Kosova nuk është shtet i përkohshëm?”

Nje diskutues në tryezë ka thënë se çështja e veriut duhet të shfrytëzohet nga Kosova për të ecur para drejt një zhvillimi më të madh ekonomik dhe drejt integritetit të saj në BE, përfshirë këtu njohjen nga pesë anëtarët e mbetur të BE-së që nuk e njohin Kosovën. Fakti që çështja e veriut është e pozicionuar në kuadër të politikës ndërkombëtare, ka thënë ky folës, do të thotë se ajo ende konsiderohet si vatër potenciale e konfliktit. Ky diskutues ka propozuar që qeveria e Kosovës dhe opozita ndoshta do të duhej të diskutonin asetet negociuese të cilat Kosova mund ti shfrytëzojë gjatë zgjidhjes së problemit të veriut.

Lista e pjesëmarrësve

Sadri Ferati, Lidhja Demokratike e Kosovës
Ardian Gjini, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Dukagjin Gorani, Qeveria e Kosovës
Lutfi Haziri, Lidhja Demokratike e Kosovës
Valdete Idrizi, Platforma CiviKos
Adriatik Kelmendi, TV Koha Vision
Leon Malazogu, Instituti Demokraci për Zhvillim
Shkamb Qavdarbasha, Instituti për Politika Zhvillimore
Naim Rashiti, Grupi Ndërkombëtar i Krizave
Xhelal Svecila, Lëvizja Vetevendosje
Nexhmedin Spahiu, Analist
Azem Vllasi, Analist
Shpetim Gashi, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Alex Grigorev, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Arber Kuci, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Krystyna Marty, Departamenti Federal Zvicrran për Punë të Jashtme
Norbert Ruetsche, Departamenti Federal Zvicrran për Punë të Jashtme
Okan Uzun, Departamenti Federal Zvicrran për Punë të Jashtme